



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 29 qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua ndër të tjera vijimi i intervalit kohor prej 1 ore për proceset në të cilat përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave për periudhën 1 Korrik 2026 deri më 31 Dhjetor 2026. Në kuadër të përgatitjeve për kalimin në intervalin 15-minutësh, u vendos gjithashtu që:

- Pjesëtarët e tregut të marrin pjesë në proceset e testeve dry-run të organizuara nga “OST” sh.a., duke kryer programimin dhe nominimin e programeve në intervale 15- minutëshe duke filluar prej datës 1 Gusht 2026.

- Deri më 6 nëntor 2026, OST do t'i paraqesë ERE-së një raport vlerësimi mbi rezultatet e testeve, problematikat e evidentuara dhe gatishmërinë e tregut për zbatimin e intervalit 15-minutësh nga 1 janari 2027.

Gjithashtu “KESH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., do të raportojnë çdo dy muaj lidhur me zbatimin e projektit që mundëson implementimin e intervalit kohor 15 minutësh në tregun e balancimit dhe mbi ecurinë e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimit përkatës.

- U miratua fillimi i procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “IDI 2005” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 8.8 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

U rishikua vendimi mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkeses së shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impanti fotovoltaiik me vendnddheje në njesinë administrative Mesopotam, Bistrice, Bashkia Finiq, qarku Vlore Ky rishikim vjen në kushtet kur shoqëria ka përditësuar projektin e saj duke përfshirë edhe ndertimin e veprave ndihmëse/ njesive të depozitimit si pjesë të impiantit fotovoltaiik por pa ndryshuar kapacitetin e instaluar 49.96 MW.

Në kuadër të çështjeve të tjera; u trajtuan informacionet :

- Mbi aplikimin e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike

- Mbi kërkesën për interpretim të shoqërisë En.Ku sh.p.k. për amendimin/vazhdimësinë të kontratës së shitblerjes së energjisë;

- Mbi qëndrimin e shoqërisë ost sh.a. lidhur me rishikimin e komponentes nxitëse dhe administrimin e fondeve të krijuara nga tregu i balancimit të energjisë elektrike.